



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
*REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO*

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**

---

Numri i lëndës: 2024:028514

Datë: 19.03.2024

Numri i dokumentit: 05473297

PPP.nr.09/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, në çështjen juridike përbarimore të kreditorit, F.K., nga Fshati Medvec Komuna e Prizrenit, i cili me prokurë përfaqësohet nga avokati S.M., me seli në Prizren, ndaj debitorëve, B.K., B.K., S.K, dhe L.K., që të gjithë nga Fshati Medvec Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim përfaqësohen nga avokat N.E., me seli në Prizren, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorëve, të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.39/24 të datës 12.01.2024 të lejuar nga Përbaruesi Privat Rushit Hoxha me seli në Prizren, jashtë seancës me datë 19.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorëve, B.K., B.K., S.K., dhe L.K., që të gjithë nga Fshati Medvec Komuna e Prizrenit, i ushtruar kundër Urdhrit për përbarim, P.nr.39/24 të datës 12.01.2024 të lejuar nga Përbaruesi Privat Rushit Hoxha me seli në Prizren, dhe i njëjti Urdhër për përbarim, LIHET NË FUQI.

II. DETYROHET, debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t'ia paguaj kreditorit shumë prej 104.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

**A r s y e t i m**

Përbaruesi Privat Rushit Hoxha nga Prizreni, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit F.K., nga Fshati Medvec Komuna e Prizrenit, ka caktuar urdhrin përbarimor P.nr.39/24 të datës 12.01.2024, duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit përbarimor, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.1104/2018, i dt.11.10.2023 i plotfuqishëm nga data 08.11.2023, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 24.11.2023, me të cilin i ka urdhëruar debitorët, B.K., B.K., S.K., dhe L.K., që të gjithë nga Fshati Medvec Komuna e Prizrenit, që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit në emër të kompensimit të dëmit shumë prej 3,000.00 euro, dhe shpenzimet e procedurës kontestimore shumë prej 300.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës së përbarimit, në të kundërtën përbarimi të realizohet

me ndalimin e mjeteve dhe shitjen e sendeve të luajshme dhe të paluajshme deri në përmbushjen e kërkesës së kreditorit.

I autorizuari i debitorëve në afatin ligjor ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin e përmbaruesit privat, për shkak të shkeljeve esenciale, vërtetimi jo i plotë dhe i gabueshëm i gjendjes faktike dhe shkeljeve të dispozitave materiale, me propozim që Gjykata Themelore në Prizren urdhrin për përmbarim të Përmbaruesit Privat P.nr.39/2024 ta hudhë jashtë fuqie si dhe kjo çështje të udhëzohet në kontest të rregullt civil, tutje ka shtuar se përkundër faktit se si titull ekzekutiv kreditori e ka parashtruar Aktgjykimin e plotëfuqishëm, e kontestojmë këtë aktgjykim, me arsyetim se i njëjti është bërë i formës së prerë pa u ushtruar ankesë kundër tij, pasi objektivisht i autorizuari i tyre ka qenë në botën e jashtme dhe aktgjykimi është bërë i plotëfuqishëm, po ashtu në këtë Gjykatë është paraqitur kërkesë për rikthim të afatit.

Përgjigje në prapësimin e debitorëve, ka parashtruar i autorizuari i kreditorit me propozim që propozimi për përmbarim të aprovohet nga ana e gjykatës sepse ka bazë ligjore, ngase Aktgjykimi C.nr.1104/18 i datës 11.10.2023 është bërë i plotëfuqishëm me datën 08.11.2023 dhe i ekzekutueshëm me datën 24.11.2023, ashtu që debitorët kanë qenë të detyruar ta përmbushin detyrimin në afatin ligjor prej 15 ditësh. Tutje ka shtuar se pretendimet e debitorëve nuk qëndrojnë dhe nuk kanë mbështetje ligjore për një gjë të tillë, ndërsa lëshimi i afatit për ushtrimin e mjetit të rregullt juridik, nuk e detyron Gjykatën që ta pezullojë apo anuloj procedurën e përmbarimit. I ka propozuar gjykatës të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorëve dhe të detyrohen debitorët që të paguajnë shumën e detyrimit si dhe shpenzimet e procedurës së përmbarimit të specifikuar në këtë përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorëve të paraqitura në prapësim dhe pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorëve është i pa bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të mbetet në fuqi, dhe atë për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se, organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht aktgjykimi në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti se i njëjti, në kuptim të nenit 22 paragrafit 1, pika 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues mbi bazën e të cilit mund të caktohet përmbarimi, në këtë çështje përmbarimore, ndërsa sipas nenit 24 par.1 të LPP-së, thuhet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilën është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje është i përmbarueshëm po qe se ka marrë formën e prerë si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”,* po ashtu gjykata gjeti se aktgjykimi në fjalë i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1 të LPP-së, e sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shumat dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pra ky dokument përmbarimor i përmban të gjitha të dhënat për tu përmbaruar në procedurën e

përmbarimit, me këtë vendim gjyqësor është urdhëruar përmbushja e detyrimit në të holla, nga ana e debitorëve, e më gjerësisht me përshkrimin e bërë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se aktvendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor i plotëson kushtet sipas nenit 36, paragrafi 1 të LPP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: “*Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri*”, andaj, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.1104/2018, i dt.11.10.2023 i plotfuqishëm nga data 08.11.2023, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 24.11.2023, dhe i njëjti aktgjykim është në origjinal, dhe e përmban klauzolën e përmbarueshmërisë dhe të ekzekutueshmërisë, dhe se për këtë arsye, pala kreditore, ka bërë propozimin për përmbarim të dhunshëm të këtij vendimi gjyqësor, te përmbaruesi privat si organ i përmbarimit. E sa i përket prapësimit si mjet i rregullt juridik në procedurën e përmbarimit, të paraqitur kundër një vendimi të organit përmbarues, e në rastin konkret të Urdhrit të lartcekur për përmbarim të përmbaruesit privat, bëhet fjalë në nenin 69 të LPP-së, ndërsa për shkaqet e parapara për prapësim, bëhet fjalë në nenin 71 të LPP-së, derisa shkaqet e thirrura në prapësimin e palës debitore, nuk përbën asnjërin nga shkaqet e parapara sipas këtij neni.

Gjykata rikujton se në këtë procedurë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e rrethanave tjera, me përjashtim të vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së tij, dhe pretendimet e dhëna të debitorëve në prapësim, nuk janë pengesë për kryerjen e përmbarimit.

Bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore.

Në raport me shpenzimet e procedurës, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, në mbështetje të dispozitave nga neni 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim, në shumën prej 104.00 euro, dhe atë sipas nr tarifor 6. përpilimi i parashtrësave në procedurën civile dhe procedurat tjera, sipas OAK-së.

Nga sa më sipër, bazuar në nenin 3 dhe 73 par.3 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

#### GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.09/2024

Datë 19.03.2024

Gjyqtari  
Sami Gashi

Numri i lëndës: 2024:028514  
Datë: 19.03.2024  
Numri i dokumentit: 05473297

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë të paraqes ankesë brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.